



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

KOMISIONI PËR PUNËN, ÇËSHTJET SOCIALE DHE SHËNDETËSINË

Tiranë, më 30.04.2021

Dokument parlamentar

(Komision për dhënie mendimi)

RAPORT

“PER

AKTI NORMATIV NR. 15, datë 7.4.2021 “PËR NJË NDRYSHIM NË AKTIN NORMATIV NR.1 DATË 10.01.2021, "PER MIRATIMIN E TEKSTIT TE MARREVESHJES, PER PRODHIMIN DHE FURNIZIMIN, NGA DHE NDERMJET PFIZER EXPORTB.V., DHE MINISTRISE SE SHENDETESISE DHE MBROJTJES SOCIALE TE SHQIPERISE, INSTITUTIT TE SHENDETIT PUBLIK, DHE MINISTRIT TE SHETIT PER RINDERTIMIN, AUTORIZIMIN E PROCEDURES PER LEJIMIN E HYRJES DHE ADMINISTRIMIT TE V AKSINA VE ANTI-COVID-19 NE REPUBLIKEN E SHQIPERISE SI DHE PERDORIMIN E TYRE NE POPULLATE”, MIRATUAR ME LIGJ NR. 2/2021, TE NDRYSHUAR”

I. Hyrje

Akti normativ Nr.15 date 07.04.2021 “Për një ndryshim në aktin normativ nr.1 datë 10.01.2021, "Për miratimin e tekstit të marrëveshjes, për prodhimin dhe furnizimin, nga dhe ndrmjet Pfizer Export B.V., dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Institutit të Shëndetit Publik, dhe Ministrit të Shtetit për Rindërtimin, autorizimin e procedurës për lejimin e hyrjes dhe administrimit të vaksinave anti-covid-19 në Republikën e Shqipërisë si dhe përdorimin e tyre në popullatë", miratuar me ligj nr.2/2021, te ndryshuar” është propozuar nga Këshilli i Ministrave.

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, e shqyrton projektligjin në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi bazuar në nenet 32-38 të Rregullores së Kuvendit. Relator për këtë Akt Normativ ishte znj. Klodiana Spahiu. Të ftuar gjatë mbledhjes së Komisionit ishin dhe përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes

Social, më konkretisht Zv/ministria znj.Mira Rakacolli, Sekretarja e Përgjithshme znj. Geraldina Prodani dhe Drejtoresha Juridike znj.Antoneta Njehrrrena.

Ky akt normativ nuk është planifikuar në planin e përgjithshëm analitik të projektakteve të vitit 2021.

II. Baza ligjore Kushtetuese

Akti normativ i Këshillit të Ministrave është në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë, neni 101 të saj.

Akti normativ shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68, të Rregullores së Kuvendit.

III. Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e aktit normativ.

Qëllimi

Qëllimi i këtij akti normativ është miratimi i tekstit të marrëveshjes për prodhimin dhe furnizimin, nga dhe ndërmjet Pfizer Export B.V., Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik.

Gjithashtu ky akt ka për qëllim të aprovojë përdorimin në popullatë të vaksinave anticovid-19, të cilat aprovohen për përdorimin në popullatë bazuar në aprovimin e Food and Drugs Administration (FDA) të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe/ose European Medicine Agency (EMA) të Bashkimit Evropian, të trupave të tjerë certifikues të vendeve që prodhojnë vaksina anticovid 19 si dhe vendeve të mbajtësit të autorizimit të tregtimit për për vaksinat anticovid.

Risitë

Pandemia e shkaktuar nga SARS-CoV-2 (Coronavirus i ri, COVID-19) ishte një sfidë globale jo vetëm për faktin se ishte një virus i ri dhe i panjohur, por edhe për shkak të numrit të lartë të personave të prekur dhe atyre që kanë pësuar fatalite në mbarë botën. Në këto kushte, qeveria shqiptare, ashtu si qeveritë e shteteve të tjera të rajonit, Evropës dhe botës, ka ndërmarrë një sërë masash për parandalimin dhe kufizimin e shpërndarjes së virusit në popullatë.

Ne kushtet aktuale, vendosja e një vaksine të sigurt dhe efektive COVID-19 është thelbësore për rikthimin e një normaliteti jetësor.

Aktualisht, Shqipëria është bërë pjesë e aleancës COVAX dhe një pjesë e vaksinave do të sigurohen nëpërmjet kësaj aleance në të cilën Shqipëria ka aderuar nëpërmjet ligjit nr.134/2020.

Shume vende të përfshira në alencën COVAX kanë lidhur marrëveshje të drejtperdrejta për sigurimin e vaksinës me kompaninë Pfizer B.V. të tilla si Serbia, Maqedonia dhe disa vende të BE-së.

Numri i siguruar i vaksinave nga marrëveshja me kompaninë Pfizer B.V nuk ishte i mjaftueshëm për vaksinim masiv të popullsisë. Në këto kushte Qeveria Shqiptare me anë të marrëveshjes, ndërmjet distributorit të autorizuar “Keymen Ilaç Sanayi ve ticaret” dhe A.S dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, të datë 23.03.2021, Republika e Shqipërisë

është funizuar me vaksinën e inaktivizuar kundër Covid-19 (Vero Cell), Coronavac, të krijuar nga Sinovac Life Science Co, Ltd të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës miratuar me Aktin Normativ nr.10 të datës 25.03.2021.

Në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është ngritur një grup pune me specialistë të ministrisë dhe të strukturave të varesise, i cili vlerësoi kontratën e propozuar nga Pfizer, dhe zhvilloi negociatën për marrëveshjen.

Përmbajtja e aktit normativ

Akti normativ përbëhet nga 2 nene gjithsej.

- Neni 1 parashikon vaksinat anti-covid-19 aprovohen për përdorimin në popullatë bazuar në aprovimin e Food and Drugs Administration (FDA) të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe/ose European Medicine Agency (EMA) të Bashkimit Evropian, të trupave të tjerë certifikues të vendeve që prodhojnë vakcina anticovid 19 si dhe vendeve të mbajtësit të autorizimit të tregtimit për vaksinat anticovid.
- Neni 2 parashikon që ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

IV. Efektet financiare

Nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje shoqërohet me efekte financiare të cilat do të perballohen nga fondi rezerve i buxhetit të shtetit.

V. Shqyrtimi i projektligjit në komision.

Akti normativ u prezantuar nga përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë, Zv/Ministria znj. Mira Rakacolli, ku ndër të tjera theksoj se vaksinimi i popullsisë është një ndër prioritetet e qeverisë në këtë kohë për menjanimin sa më të madhe të përhapjes së virusit Covid -19. Gjithashtu znj.Rakacolli përmëndi që në Shqipëri janë vaksinuar rreth 450.000 mijë njerëz me 4 vaksinat që janë të certifikuar nga institucione të Food and Drugs Administration (FDA) të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe/ose European Medicine Agency (EMA) të Bashkimit Evropian, të trupave të tjerë certifikues të vendeve që prodhojnë vakcina anticovid 19 si dhe vendeve të mbajtësit të autorizimit të tregtimit për vaksinat anticovid.

Gjithashtu znj. Rakacolli përmëndi që marrëveshja që sot propozohet për miratim në Komision, është ndryshimi i paketimit të vaksinës Coronavac e prodhuar në Turqi. Duke qënë se ky ndryshim i paketimit vjen në një dozë të re të vaksinës duhet dhe miratimi nga Komisioni.

Relatori i Komisionit znj. Spahiu, në fjalën e saj u shpreh se Akti normativ krijon mundësinë ligjore për rritjen e numrit të të vaksinuarve në Shqipëri. Për rrejdhojë të akteve të miratuar për menaxhimin e pandemisë nga Parlamenti, Shqipëria me anë të 4 vaksinave të çertifikuara që përdor për vaksinimin e popullsisë, do të arrij në pranverën e vitit 2022 të vaksinojë të gjithë popullsinë.

VI. Përfundime.

Në përfundim të shqyrtimit Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, vlerësoi se miratimi i këtij akti normativ në kushtet e nevojës dhe urgjencës, do të ketë impakt pozitiv në mbrojtjen e shëndetit publik, dhe me votat pro të të gjithë anëtarëve të pranishëm, e miratoi Akti Normativ Nr.15 date 07.04.2021 “Për një ndryshim në aktin normativ nr.1 datë 10.01.2021, "Për miratimin e tekstit të marrëveshjes, për prodhimin dhe furnizimin, nga dhe ndrmjet Pfizer Export B.V., dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, Institutit të Shëndetit Publik, dhe Ministrisë së Shtetit për Rindërtimin, autorizimin e procedurës për lejimin e hyrjes dhe administrimit të vaksinave anti-covid-19 në Republikën e Shqipërisë si dhe përdorimin e tyre në popullatë", miratuar me ligj nr.2/2021, te ndryshuar” është propozuar nga Këshilli i Ministrave.

RELATOR

Klodiana SPAHIU

KRYETAR

Enver ROSHI